



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 64 datë 30.12.2015

**Për
“MIRATIMIN E NISMËS PËR HARTIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM
VENDOR PËR BASHKINË E TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, neni 10, pika 3, paragrafi “I”, shkronja “g” dhe nenit 33, pika 2 të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000, për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 5 pika I/3 shkronja “b”, nenit 12, pika 2 shkronja “a” dhe nenit 58 të ligjit nr.107/2014, datë 31.07.2014, për “Planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar); nenit 3, pika 3, nenit 11, nenit 58, pika 1, shkronja “b”, pika 2 dhe pika 4 të shtojcës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.671, datë 29.07.2015 për “Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”; pikën 1 të vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr.1, datë 29.07.2015 për “Përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e planeve të përgjithme vendore”, vendimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë Nr.22274, datë 23.12.2015, për “Ndërmarrjen e nismës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë e Tiranës me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë nismën për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë e Tiranës, të ndërmarrë me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. Nr.22274, datë 23.12.2015 për “Ndërmarrjen e nismës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë e Tiranës” sipas dokumentit bashkëlidhur pjesë përbrëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës për ndjekjen e mëtejshme të procedurave për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor sipas akteve në fuqi për planifikimin.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e këtij vendimi në rregjistrin e integruar të territorit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, në Bashkinë e Tiranës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

ALDRIN DALIPI